

VENDIM Nr. 4

i

Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

(Marrë në zbatim të neneve 168, 169 dhe 177 e në vijim

të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”).

Sot, në datën 05 Qershor 2018, në selinë e shoqërisë tregtare “ALBANIA GAS TECH” SHA me adresë: “Pjezë, Xhafzotaj - Durrës”, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Aksionarëve të kësaj shoqërie me rend dite:

- 1) Rritjen e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “ALBANIA GAS TECH” SHA me vlerë 74 491 000 LEKE me rezervat e disponueshme të akumuluar, pasqyruar në bilancin e vitit 2017 dhe në bilancin e reformuar me datë 05 Qershor 2018, në zbatim të nenit 177 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 2) Caktimin e Audituesit Ligjor për të përgatitur raportin për zmadhimin e kapitalit të regjistruar për vlerën 74 491 000 LEKE.
- 3) Të tjera

Në mbledhjen e Asamblesë morën pjesë aksionarët që zotërojnë 100 % të kapitalit, si vijon:

- i. Shefit KASTRATI 50%
- ii. Mujo NERGUTI 50%

Asambleja konstatoi se:

Në bilancin kontabël të vitit 2017 janë pasqyruar rezerva të disponueshme me vlerë 74 491 243 LEKE, të akumuluar nga shpërndarja e fitimeve të viteve të mëparshme, miratuar me vendimet e Asambleve të viteve përkatëse si vijon:

| Viti i krijimit | Vendimi i Asamblesë | | Vlera e fitimit, kaluar në Rezerva |
|---------------------------------|---------------------|------------|------------------------------------|
| | Nr. | Datë | |
| Nga fitimi i vitit 2017 | 3 | 28.05.2018 | 25,812,503 |
| Nga fitimi i vitit 2016 | 5 | 20.06.2017 | 19,961,418 |
| Nga fitimi i vitit 2015 | 3 | 22.06.2016 | 15,142,386 |
| Nga fitimi i vitit 2014 | 2 | 30.06.2015 | 13,574,936 |
| Totali | | | 74,491,243 |
| Rezerva të kapitalizuara | | | (74,491,000) |
| Rrumbullakosje aksioni | | | 243 |

Në përfundim Asambleja e Përgjithshme,

V E N D O S I:

1. Të rrisi kapitalin e regjistruar të shoqërisë “ALBANIA GAS TECH” SHA me rezervat e disponueshme të pasqyruara në pasqyrat financiare 2017 dhe bilancin e reformuar për vlerën 74 491 000 LEKE.

| Viti i krijimit | Vlera e fitimit, kaluar në Rezerva | Rezerva të kapitalizuara |
|-------------------------|------------------------------------|--------------------------|
| Nga fitimi i vitit 2017 | 25,812,503 | 25,812,500 |
| Nga fitimi i vitit 2016 | 19,961,418 | 19,961,400 |
| Nga fitimi i vitit 2015 | 15,142,386 | 15,142,200 |
| Nga fitimi i vitit 2014 | 13,574,936 | 13,574,900 |
| Totali | 74,491,243 | 74,491,000 |

2. Pas rritjes, kapitali i regjistruar i shoqërisë nga 26 349 000 bëhet 100 840 000 LEKE.
3. Rritja do të shlyhet me rezervat e disponueshme, pasqyruar në pasqyrat financiare 2017 dhe bilancin e reformuar me datë 05 Qershor 2018.
4. Audituesi ligjor që do të përgatiti raportin për zmadhimin e kapitalit është Zj. Marije DUSHI, me licencë profesionale nr. 51, datë 10.02.2000 auditues - partner dhe ortakë e shoqërisë “FICADEX ALBANIA” SHPK.
5. Regjistrimi në QKB të bëhet brenda afatit ligjor.
6. Për kryerjen e veprimeve përkatëse në QKR Autorizohet Z. Indrit Qehaja

Aksionarët e shoqërisë “ALBANIA GAS TECH” SHA

Shefit KASTRATI



Mujo NERGUTI



“ALBANIA GAS TECH” SHA

L11718501C

Pjezë - Xhafzotaj, Durrës

VENDIM Nr. 5

i

Asamblesë së Përgjithshme

Sot, në datën 13 Qershor 2018, në selinë e shoqërisë tregtare “ALBANIA GAS TECH” SHA me adresë: “Pjezë - Xhafzotaj, Durrës”, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të kësaj shoqërie me rend dite:

1. Miratimin e Raportit të Audituesit ligjor, i përgatitur për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “ALBANIA GAS TECH” SHA me kalimin/(kapitalizimin) e rezervave të disponueshme;
2. Të tjera.

Në mbledhjen e Asamblesë morën pjesë aksionarët që zotërojnë 100 % të kapitalit, si vijon:

i. Shefit KASTRATI 50%

ii. Mujo NERGUTI 50%

Në përfundim të mbledhjes Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

- 1) Miratimin e raportit të paraqitur nga zj. Marije DUSHI, Auditues Ligjor - ortake e shoqërisë “FICADEX ALBANIA” SHPK, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me kalim (kapitalizim) të rezervave të disponueshme, në zbatim të vendimit të ortakut nr. 4 datë 05 Qershor 2018.
- 2) Kapitali i regjistruar i shoqërisë zmadhohet me vlerën 74,491,000 LEKE. Pas zmadhimit, kapitali i regjistruar nga 26,349,000 LEKE bëhet 100,840,000 LEKE. Kapitali zotërohet 50 % nga Ortaku Shefit KASTRATI dhe 50% nga ortaku Mujo NERGUTI.
- 3) Shlyerja 100% e vlerës së rritjes së kapitalit të regjistruar është bërë me kalimin e rezervave të disponueshme, sipas pasqyrës së pozicionit financiar (bilancit) të reformuar me datë 07 Qershor 2018.
- 4) Ky vendim të depozitohet në Q.K.B dhe në departamentin e kontabilitetit.
- 5) Për të kryer veprimet përkatëse në QKR lidhur me depozitimimin e këtij vendimi, autorizohet Z. Indrit Qchaja.

Aksionarët e shoqërisë “KASTRIOT & PETROL” SHA

Shefit KASTRATI

Mujo NERGUTI

